



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 104, Datë 27.02.2020

PËR

VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN PËRFUNDIMTAR TË KANDIDATIT Z.{...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 27.02.2020, në kuadër të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e tij nr. 108, datë 09.07.2019, pas përfundimit të intervistës me kandidatin z. {...}, bazuar në të dhënat që rezultuan nga intervista, sikundër edhe nga të dhënat e rezultuara nga dokumentet e paraqitura nga kandidati dhe ato të administruara gjatë procedurës së përzgjedhjes, mbasi shqyrtoi projekt vendimin “Për vlerësimin dhe pikëzimin përfundimtar të kandidatit z. {...}” përgatitur nga relatori i çështjes,

V Ë R E N :

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, sipas shkronjës “c”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

2. Me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në *fushën e të drejtës administrative*.

3. Por pozicionin e lirë të shpallur si më lart, brenda afatit të përcaktuar, ka aplikuar edhe kandidati z. {...}.

4. Për kandidatin z. {...}, sikundër edhe për kandidatët e tjerë, fillimisht Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikoi plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit dhe, në përfundim, me Vendimin nr. 257, datë 12.11.2019, vendosi: *“Kualifikimin e kandidatit jogjyqtar z. {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*.

5. Ndërkohë, me Vendimin nr. 260, datë 13.11.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: *“Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*. Në këtë rast, Këshilli, përmes shortit, ka caktuar dhe relatorin për këtë procedurë përzgjedhjeje për emërim në Gjykatën e Lartë.

6. Në kuadër të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, në zbatim të nenit 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të Vendimit të tij nr. 102, datë 05.07.2019 “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 102/2019), si dhe të Vendimit të tij nr. 209, datë 11.10.2019 “Për miratimin e “Metodologjisë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë” (më poshtë referuar si Metodologjia e Vlerësimit dhe Pikëzimit), Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.101, datë 26.2.2020, miratoi vlerësimin dhe pikëzimin paraprak për kandidatin z. {...}. Sipas këtij vendimi, kandidati është vlerësuar dhe pikëzuar paraprakisht me 87 pikë në total.

7. Në vijim të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, pas vlerësimit dhe pikëzimit paraprak, ndërsa kandidati z. {...} u identifikua si një nga kandidatët e listuar më mirë, praktikisht i vetmi, në zbatim të pikës 7, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, sikundër dhe Vendimit të tij 102/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi me kandidatin një intervistë, në një seancë publike, më datë 27.2.2020.

8. Gjatë intervistës, kandidati u pyet nga Këshilli, duke marrë nga ai përgjigjet në lidhje me: motivet dhe arsyet që e kanë shtyrë për të kandiduar për në Gjykatën e Lartë, duke specifikuar dhe objektivat që kishte nëse emërohej gjyqtar i kësaj gjykate; elementët e formimit dhe të eksperiencës së tij që, sipas opinionit të tij, e kishin përgatitur për të adresuar çdo aspekt në lidhje me juridiksionin e Gjykatës së Lartë; rolin e Gjykatës së Lartë në shoqëri, sfidat përpara saj dhe strategjia e tij për kapërcimin e tyre; masat konkrete që mund të merren për reduktimin e

“backload”-it në Gjykatën e Lartë; dhe dilemën etike më sfiduese që kishte pasur në jetë dhe mënyrën si e kishte zgjidhur atë.

9. Pas intervistës me kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vijoi shqyrtimin dhe vendosi në lidhje me vlerësimin dhe pikëzimin përfundimtar të kandidatit për secilën kategori, kriter, nënkriter dhe tregues, të përcaktuar në pikën 6, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të detajuara më tej në Vendimin e tij 102/2019, ku përcaktohen në detaje ndarja e kategorive të vlerësimit në kritere, lista e kriterëve që përbëjnë secilën kategori, treguesit vlerësues për pikëzimin, pikëzimi maksimal i secilës kategori dhe kriter, si edhe burimet dokumentare dhe disa të dhëna për metodologjinë në funksion të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si dhe Metodologjinë e Vlerësimit dhe Pikëzimit, e cila shpjegon orientimet që mban parasysh Këshilli në vlerësimin dhe caktimin e pikëve sipas secilës prej kategorive të meritave të kandidatëve.

10. Sipas akteve normative të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë vlerësohet dhe pikëzohet për tre kategori vlerësimi, të cilat më tej detajohen në kritere dhe nënkritere, ku secila nga ato vlerësohet dhe pikëzohet.

11. Kategoria e parë e vlerësimit është “Meritat profesionale”. Kjo kategori vlerësimi ndahet në tre kritere, të cilët nga ana tjetër ndahen në nënkritere dhe një prej tyre edhe në tregues.

12. Kriteri i parë i Kategorisë “Meritat profesionale”, është “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”. Ky kriter vlerësimi ndahet në pesë nënkritere, e më konkretisht:

- a) “Historiku arsimor” ose “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi”;
- b) “Rezultatet e programeve të formimit fillestar”;
- c) “Rezultatet e përvojës në profesion”;
- ç) “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”
- d) “Aftësitë gjuhësore.

13. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Historiku arsimor” ose “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi”:

13.1 Neni 49, pika 6, shkronja “c”, e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe Vendimi i Këshillit 102/2019 dalë në zbatim të ligjit, për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatit përcaktojnë edhe rezultatet e studimeve

të larta për drejtësi. Ndërkohë, sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, nënkriteri “Historiku arsimor” apo “Rezultatet e studimeve të larta për drejtësi” vlerësohet dhe pikëzohet deri në 2 pikë, duke iu referuar mesatares së notave jo më pak se 8, ose të barasvlershme me të, nëse studimet janë përfunduar jashtë vendit. Për vlerësimin e kandidatëve caktohet 1 pikë, duke filluar nga mesatarja e notave 8.

13.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka ndjekur studimet universitare dhe për këtë u administruan:

- Diplomë nr. 1654.B, me nr. regjistri 1386, lëshuar më datë 25.06.1986, nga Universiteti i Tiranës, sipas të cilit kandidati {...}, në periudhën 1982 - 1986, ka kryer kursin e plotë të Fakultetit të Shkencave Politike e Juridike të Universitetit të Tiranës në Degën “Drejtësi” dhe me vendim të komisionit shtetëror të datës 25.06.1986 i është dhënë titulli “Jurist”

-“Lista e Rezultateve të Provimeve”, lëshuar më datë 05.07.1986, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike.

13.3 Sipas dokumenteve të administruara, kandidati z. {...} ka përfunduar studimet e larta për drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe është diplomuar “jurist” në vitin 1986. Referuar Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, arsimi i kandidatit kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Ndërkohë, sipas listës së rezultateve të provimeve, lëshuara nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, sikundër edhe nga vetëdeklarimi i kandidatit në jetëshkrimin e tij, rezulton se mesatarja e studimeve të tij universitare 4-vjeçare është 9,8.

13.3 Ndaj nga sa rezultoi, për nënkriterin e vlerësimit “Historiku arsimor” apo Rezultatet e studimeve të larta për drejtësi”, duke pasur parasysh notën mesatare të studimeve në drejtësi të kandidatit, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 2 pikë.

14. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Rezultatet e programeve të formimit fillestar”:

14.1 Neni 49, pika 6, shkronja “c” i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe Vendimi 102/2019, përcaktojnë si nënkriter për të vlerësuar aftësitë profesionale të kandidatëve *rezultatet e programit fillestar*. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit në programet e formimit profesional përfshihen Shkolla e Magjistraturës, Shkolla e Avokatisë, Shkolla e Administratës Publike, etj., të cilat kontribuojnë në rritjen e profesionalizmit. Me anë të këtij kriteri vlerësohet niveli i rezultateve të angazhimit të kandidatit në ndjekjen e veprimtarive të kualifikimit fillestar profesional që mundësojnë arritjen e

një profesionalizmi më të lartë në shërbim të ushtrimit të funksioneve dhe detyrave profesionale. Për këtë nënkriter Këshilli cakton 1 pikë për rezultatet e studimeve të vlerësuara një nivel më të ulët se niveli maksimal (“mirë” ose “shumë mirë”, sipas programit) dhe 2 pikë për rezultate të vlerësuara në nivelin maksimal (“shumë mirë” ose “shkëlqyeshëm”, sipas programit).

14.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati {...} nuk rezulton të ketë ndjekur programe të formimit fillestar të tilla si Shkolla e Magjistraturës, Shkolla e Avokatisë, Shkolla e Administratës Publike etj.

14.3 Ndaj nga sa rezultoi, për nënkriterin e vlerësimit “Rezultatet e programit fillestar”, duke pasur parasysh se kandidati nuk ka ndjekur programe të formimit fillestar, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 0 pikë.

15. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Rezultatet e përvojës në profesion”:

15.1 Neni 49, pika 6, shkronja “c” i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe Vendimi 102/2019, përcaktojnë si nënkriter për të vlerësuar aftësitë profesionale të kandidatëve *rezultatet e përvojës në profesion*. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit me anë të këtij nënkriteri vlerësohet niveli i rezultateve të arritura gjatë përvojës së kandidatit në profesionin e juristit. Duke marrë parasysh të dhënat dhe informacionet në dispozicion, Këshilli cakton 2 pikë për rezultatet e arritura gjatë përvojës profesionale si jurist të vlerësuara një nivel më të ulët se niveli maksimal (“mirë” ose “shumë mirë”, sipas llojit të profilit) dhe 4 pikë për rezultatet e vlerësuara në nivelin maksimal (“shumë mirë” ose “shkëlqyeshëm”, sipas llojit të profilit). Për kandidatët për të cilët nuk ka vlerësime nga sisteme zyrtare vlerësimi, do të merren për bazë opinionet vlerësuese të strukturave drejtuese të organizmave ku ata bëjnë pjesë (*si për shembull departamenti ose dekanati, dhoma e avokatisë, dhoma e noterëve, dhoma e ndërmjetësuesve etj.*).

15.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z.{...} ka përvojë të gjatë si jurist ndërsa për rezultatet e përvojës në profesion u administruan disa opinione vlerësuese të strukturave drejtuese të organizmave ku ai ka bërë ose bën pjesë, e më konkretisht:

-Vlerësimin e marra në rolin e ekspertit në kuadër të programeve dhe trajnimeve të zhvilluara pranë këtij institucioni në lidhje me Programin e Formimit Fillestar Vazhdues nga Shkolla e Magjistraturës me shkresë nr.906 prot., datë 19.11.2019 nga ku rezultoi se ai është listuar ndër pedagoget më të aftë dhe më të mirë në drejtimin praktik dhe akademik, përsa i përket procesit të mësimdhënies. Të njëjtat vlerësime ka marrë edhe nga magjistratët në detyrë gjatë aktivizimit si ekspert në tema të ndryshme në kuadër të Programimit të Formimit Fillestar ndër vite.

- Përvojë profesionale, në kuadër të dokumentacioneve të paraqitura nga kandidati {...} të Vendime të Gjykatës Kushtetuese si indikator të veprimtarisë së tij 13 vjeçare si gjyqtar, ka paraqitur vendime gjyqësorë ku ai ka qenë pjesë e trupit gjykues ose relator i çështjes gjyqësorë. Në kushtet kur një parim i vjetër shprehet *se jemi nën kushtetutën, por Kushtetuta është ajo çfarë gjyqtarët thonë se është*, kandidati {...} nëpërmjet vendimmarrjes kolegjiale të Gjykatës Kushtetuese ka pasuruar jurisprudencën duke identifikuar mjaft parime shtet formuese të tilla si: konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, pluralizmi, ndarja dhe balancimi i pushteteve, decentralizimi dhe auto-nomia vendore, uniteti i pushtetit, dinjiteti njerëzor, pavarësia e gjyqësorit, barazia sociale, mos diskriminimi, apo edhe vlera të tjera kushtetuese si siguria juridike, të drejtat e fituara, pritshmëritë legjitime dhe besimi i qytetarëve tek shteti. Në këto vendime janë argumentuar se deri në çfarë mase parime të tilla të përgjithshme si ato më sipër, të cilat derivojnë natyrshëm jo vetëm nga teksti por edhe nga fryma e Kushtetutës, përbëjnë një bazë solide në funksion të ngritjes dhe të argumentimit të një kërkesë për antikushtetushmërinë e një ligji që i ka cenuar ato.

- Rekomandimin e përcjella nga Universiteti “Luarasi” për veprimtarisë së tij si Rektor dhe pedagog, në kuadër dokumentacioneve të paraqitura, kandidati {...} me shkresë nr. 3996/3 prot., datë 20.11.2019 protokolluar nga Këshilli nga ku rezultoi se ”...omissis. *Eksperiencia e profesor {...}, profesionalizmi dhe ekspertiza e thelluar ka nxitur dhe ndihmuar Fakultetin e Drejtësisë, të rritet vit pas viti, të krijojë profilin e lartë publik, besueshmërinë, seriozitetin dhe angazhimin e profesionalisteve më të mirë të fushës.. omissis.*”

15.3 Sipas dokumenteve të administruara, opinioneve vlerësuese të drejtuesve të institucioneve, subjekteve dhe organizatave si më lart, ku kandidati ka marrë pjesë, rezultoi se kandidati dhënë kontribut dhe ka treguar profesionalizëm, përgjegjshmëri dhe përpikmëri. Ka treguar aftësi organizative dhe drejtuese e vizion të qartë në mbarëvajtjen e punës. Nga burimet e vlerësimit kandidati është nderuar me titullin “Albanian Excellence- Histori Suksesi 2015 për profesionalizëm, përkushtim dhe maturinë e treguar në zhvillimin dhe pasurimin e jurisprudencës dhe të çështjeve që lidhen me reformimin e drejtësisë shqiptare”. Si dëshmi të rezultateve të larta të përvojës profesionale. Me përkushtimin e tij ai ka dhënë kontribut të qenësishëm në secilën prej sipërmarrjeve që ai ka marrë përsipër.

15.4 Ndaj nga sa rezultoi, për nënkriterin e vlerësimit “*Rezultatet e përvojës në profesion*”, janë marrë parasysh përfundimet e arritura nga dokumentacioni i administruar, gjithashtu dhe përgjigjeve të dhëna nga kandidati në seancën e dëgjësës publike, të zhvilluar datë 27.02.2020, ora 10.00 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 4 pikë.

16. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “*Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë*”:

16.1 Neni 49, pika 6, shkronja “c”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/209, përcaktojnë si nënkriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe *“rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”*. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit ky nënkriter është zbërthyer në tre tregues, e konkretisht:

- i) “Rezultatet e trajnimeve të tjera”;
- ii) “Rezultate e kualifikimeve pasuniversitare”;
- iii) “Rezultatet e gradave/titujve shkencorë”.

16.2 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, për vlerësimin dhe pikëzimin e këtij nënkriteri, Këshilli vlerëson: i) “Rezultatet e trajnimeve të tjera” - deri në 2 pikë; ii) “Kualifikimet pasuniversitare” - deri në 3 pikë [*2 pikë për studime, me rezultate të larta (1 pikë për mesatare 8-9; 2 pikë për mesatare 9.1-10) të kryera në Shqipëri, dhe deri në 3 pikë (1.5 pikë për mesatare 8-9; 3 pikë për mesatare 9.1-10) nëse studimet janë kryer në vendet e BE/OECD*]; si dhe iii) “Gradat shkencore dhe titujt akademikë” - deri në 4 pikë [*për rezultatet e larta, 95-100 pikë, ose ekuivalente, gjatë studimeve të doktoraturës në drejtësi, Këshilli cakton deri në 2 pikë nëse grada shkencore “Doktor” është kryer në Shqipëri, dhe deri në 3 pikë nëse grada shkencore është kryer në vendet e BE/OECD; për titullin akademik “Profesor i asociuar”, duke marrë parasysh fushën dhe institucionet e punësimit, Këshilli cakton deri në 2 pikë nëse kandidati e ka fituar titullin akademik në Shqipëri, dhe deri në 3 pikë nëse kandidati e ka fituar atë në vendet e BE/OECD; për titullin akademik “Profesor ose Professor Emeritus”, duke marrë parasysh fushën dhe institucionet e punësimit, Këshilli cakton deri në 3 pikë nëse kandidati e ka fituar titullin akademik në Shqipëri, dhe deri në 4 pikë nëse kandidati e ka fituar atë në vendet e BE/OECD*]. Në çdo rast, totali i pikëve të caktuara nuk mund të jetë më i lartë se maksimumi i pikëve për këtë kriter - 8 pikë. Për të realizuar një vlerësim sa më objektiv të kandidatëve që kanë tituj akademikë, grada shkencore, apo që kanë kryer studime të tjera afatgjata, mastera ekzekutivë dhe trajnime të tjera, mbahen në konsideratë edhe kriteret e përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë (Ligjin nr. 80/2015). Në lidhje me trajnimet e realizuara referuar Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, trajnimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, për efekt vlerësimi, duhet që të jenë të 10 (dhjetë) viteve të fundit.

16.3 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka ndjekur një sërë trajnimesh të tjera, ka kryer studime pasuniversitare si dhe ka gradë shkencore në drejtësi dhe tituj akademikë.

16.4 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Trajnime të tjera”:

16.4.1 Për treguesin “*Trajnime të tjera*” referuar jetëshkrimit, rezultoi se kandidati në dokumentet e paraqitura ka referuar një numër të madhe trajnimesh në kuadër formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës në të cilat ka qenë në rolin e trajnuesit dhe nuk rezulton të ketë trajnime të tjera të kryera nga ana e tij, të cilat janë të shoqëruara me një certifikatë ose përmbajnë një komponent vlerësimi.

16.4.2 Ndaj nga sa rezultoi, për treguesin e vlerësimit “Rezultatet e trajnimeve të tjera”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 0 pikë.

16.5 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare”:

16.5.1 Për treguesin “*Kualifikime pasuniversitare*”, referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës rezultoi se kandidati z. {...} ka kryer kualifikim pasuniversitar dhe për këtë u administrua Vërtetimi i datës 22.7.2019 të Fakultetit të Drejtësisë, nga ku rezulton se z. {...} në datën 20.12.2003 ka mbrojtur mikrotezën me titull “Kontrolli Kushtetutshmërisë së normës juridike” dhe është vlerësuar me 100 pikë (“shumë mirë”) duke iu akorduar titulli ‘Master në Shkencat Publike’.

16.5.2 Ndaj nga sa rezultoi, për treguesin e vlerësimit “Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare”, duke pasur parasysh notën mesatare të kualifikimit pasuniversitar, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 2 pikë.

16.6 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Gradat shkencore dhe titujt akademikë”:

16.6.1 Për treguesin “*Gradat shkencore dhe titujt akademikë*” referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka marrë gradë shkencore në drejtësi dhe për këtë u administrua në Vendimi nr. {...}, datë {...}i Fakultetit të Drejtësisë, rezulton se kandidati pas ndjekjes së studimeve ka mbrojtur përpara jurisë punimin me temë: “Aspekte teorike dhe Praktike të Drejtësisë Kushtetuese Shqiptare.”, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”, në përfundimit të procedurës së mbrojtjes dhe të votimit, kandidati është vlerësuar me rezultatin “Shumë mirë”, me 50 pikë nga 50 pikë maksimale

16.6.2 Ndaj nga sa rezultoi, për treguesin e vlerësimit “Gradat shkencore dhe titujt akademikë”, duke pasur parasysh rezultatin e gradës shkencore në drejtësi të kandidatit si dhe dokumentit Dëshmi me nr. Regjistri të KVTA 350, sipas të cilit ‘Z. {...}fiton titullin “Profesor i Asociuar”., Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se ai duhet të vlerësohet me 4 pikë.

16.7 Sa sipër, për nënkriterin “*Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë*”, Këshilli çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 6 pikë në total.

17. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Aftësitë gjuhësore”:

17.1 Neni 49, pika 6, shkronja “ç”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/2019 dalë në zbatim të ligjit,

përcaktojnë si nënkriter për të vlerësuar aftësitë profesionale të kandidatëve edhe “aftësitë gjuhësore”. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, nënkriteri “Aftësitë gjuhësore” vlerësohet dhe pikëzohet deri në 4 pikë, duke mbajtur parasysh njohjen nga kandidatët të pesë gjuhëve të huaja anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Për këtë, Këshilli vlerëson dhe pikëzon me përparësi njohuritë në gjuhët angleze dhe franceze, ku në varësi të shkallës së zotërimit, kandidati vlerësohet deri në 1,5 pikë për secilën gjuhë. Po ashtu, Këshilli vlerëson dhe pikëzon edhe njohuritë në gjuhët e tjera të deklaruara nga kandidati, për të cilat ai nuk testohet me kushtin që të jenë të shoqëruara me dokumente vlerësuese të vlefshme për nivelin e njohurive të tyre. Për gjuhët e tjera, të ndryshme nga anglishtja dhe frëngjishtja, kandidati kandidatit i shtohet deri një 1 pikë. Po sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, vlerësimi i kandidatit për shkallën e zotërimit të gjuhës së huaj bazohet në: testet ndërkombëtare, sipas Ligjit nr. 80/2015 dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit nr. 52, datë 03.12.2015; ose mendimin me shkrim të dhënë nga ekspertët, të cilët, pas intervistës që zhvillohet me kandidatin për këtë qëllim, japin vlerësimin e tyre për nivelin njohjes së gjuhës së huaj.

17.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezultoi që kandidati {...} zotëron gjuhën e huaj Angleze, për këtë u administruan:

-Certifikata e mbrojtjes së gjuhës angleze e datës 6.1.1992, lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, ku rezulton se është vlerësuar me notën 8 (tetë).

17.3 Sa sipër, për nënkriterin “Aftësitë gjuhësore”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin me 1 pikë sepse shkalla e zotërimit nga kandidati i gjuhës së huaj në rastin konkret nuk mund të rezultojë sipas alternativës së parë dhe asaj të dytë të vlerësimit, pra në bazë të testeve ndërkombëtare, sipas Ligjit nr. 80/2015 dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit nr. 52, datë 03.12.2015, pasi testimi dhe mbrojtja nga ai i gjuhës së huaj daton në vitet 1992. Prandaj, shkalla e zotërimit nga kandidati i gjuhës së huaj, lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, vlerësohet duke u bazuar ligjit të kohës dhe certifikatës së mbrojtjes së gjuhës angleze (vlerësuar me notë) nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

17.4 Për rrjedhojë, Këshilli në total për nënkriterin “Aftësitë gjuhësore”, e vlerësoi kandidatin z. {...} me 1 (një) pikë.

18. Përfundimisht, sa më sipër, për kriterin e vlerësimit “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 13 pikë në total.

19. Kriteri i dytë i Kategorisë “Meritat profesionale”, është “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”. Ky kriter vlerësimi ndahet në pesë nënkritere/indikatore/tregues, e më konkretisht:

- a) “Originaliteti dhe/ose impakti”;
- b) “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”;
- c) “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”;

- ç) “Interpretimi i harmonizuar”;
- d) “Referencat e praktikës gjyqësore”.

20. Neni 49, pika 6, shkronja “b”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/2019 dalë në zbatim të ligjit, përcaktojnë si kriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe vlerësimin e punës së kandidatit, përmes të paktën pesë dokumenteve ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë përvojës së tij në profesion gjatë pesë viteve të fundit, si dhe çdo publikim shkencor dhe artikull akademik në fushën e ligjit. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, vlerësimi për këtë kriter bëhet përmes vlerësimit cilësor të pesë punimeve dhe dokumenteve profesionale gjatë pesë viteve të fundit të karrierës. Po ashtu, elemente shtesë mbi cilësinë e rezultateve profesionale mund të nxirren edhe nga dokumentet zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional të paraqitura nga kandidati ose të kërkuara nga ana e Këshillit prej autoriteteve përkatëse, si edhe dokumentet zyrtare që paraqesin cilësinë dhe arritjet gjatë eksperiencës në punë, nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky kriter, pra “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”, synon të identifikojë ata kandidatë të cilët kanë performuar në mënyrë të dalluar në fushën përkatëse të ushtrimit të profesionit, prandaj vlerësimi dhe pikëzimi i kandidatëve bëhet duke u mbështetur në arritjen e rezultateve më të larta dhe të dallueshme profesionale, të konsideruara në përgjithësi, për të vlerësuar cilësinë e aftësive profesionale. Referuar Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, secilin nga pesë treguesit (“Originaliteti dhe/ose impakti”; “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”; “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”; “Interpretimi i harmonizuar”; “Referencat e praktikës gjyqësore”) vlerësohet dhe pikëzohet në maksimum me 5 pikë, e në total vlerësimi cilësor vlerësohet në maksimum me 25 pikë.

21. Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar, rezultoi që kandidati {...} ka përgatitur botime në cilësinë e autorit apo të bashkautorit, ka përgatitur publikime profesionale dhe kërkime shkencore, si dhe artikuj të tjerë profesional, si brenda dhe jashtë vendit, të cilat janë të fokusuara në shumicën e rasteve në fushën e të drejtës administrative dhe asaj kushtetuese.

22. Gjatë procedurës së përzgjedhjes u administruan pesë dokumente ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë pesë viteve të fundit, e më konkretisht:

- a) Komentar “Mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë” Bashkautor; © Fondacioni “Shoqëria e hapur për Shqipërinë” dhe Instituti për Studime Publike dhe Ligjore”, Tiranë, 2019
- b) Libri “E Drejta Administrative Procedurale” Një analizë mbi kodin e Procedurave Administrative Autor; © botimet “Toena”, Tiranë 2017.
- c) Libri “Gjykata Administrative dhe Kontrolli Ligjor mbi Administratën” Autor; © Botimet “Toena”, Tiranë 2014.
- d) Artikull shkencor “Sistemi i centralizuar i kontrollit kushtetues përballë prirjes për decentralizimin e tij”. Autor; © Revista Shkencore “Jeta Juridike”, nr. 3, Botim i Shkollës së Magjistraturës, Tiranë 2017.

- e) Artikull shkencor “Funksioni i një kushtetute dhe sfidat e saj përballë një realiteti të ri Europian”. Autor; © Revista “Avokatia”, nr. 9, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Tiranë 2014.

Për efekt vlerësimi dhe pikëzimi sipas këtij kriteri, kandidati si alternativë të dokumentit të pestë pika (e) e sipërcituar që ka dorëzuar, kërkon të përdoret dhe pjesëmarrja nga viti 2015 e në vijim, në kuadrin e **Reformës në Drejtësi**, me cilësinë e Bashkëkryetarit të Nënkomisionit për Amendamentet Kushtetuese dhe Gjykatën Kushtetuese, në hartimin e:

Analizës në sistemit të Drejtësisë në Shqipëri; Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë ; Plani i veprimit (pjesa për Kushtetutën dhe Gjykatën Kushtetuese), Projekt Kushtetuta (në tërësi) ;Projekt ligji për Gjykatën Kushtetuese (në tërësi); Botimi Parlamentar në 4 vëllime, i titulluar “Reforma në sistemin e drejtësisë”

23. Përveç sa sipër, gjatë procedurës së përzgjedhjes, kandidati u ftua të bëjë edhe një vetëvlerësim, kjo pasi, sa i përkiste vlerësimit të treguesit “Origjinaliteti dhe/ose impaktit”, nevojiteshin të dhëna konkrete të referuara nga kandidati, mbi të cilat Këshilli do të mund të identifikonte dhe të orientohej për origjinalitetin dhe/ose impaktin e pesë dokumenteve profesionale të përzgjedhur në kuadër të procesit të vlerësimit dhe pikëzimit. Gjithashtu, vetëvlerësimi, ndërsa duhej të fokusohet në treguesit e përcaktuar sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, do të shërbente edhe për një vlerësim të drejtë edhe për treguesit e tjerë të kriterit “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”.

24. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Origjinaliteti dhe/ose Impakti”:

24.1 Për indikatorin “Origjinaliteti dhe/ose Impakti”, pasi shqyrtoi përmbajtjen e dokumenteve si më lart, Këshilli vlerësoi se ato dokumente përbëjnë punë origjinale të autorit, trajtimi i cilave sjell parashtrime, argumente dhe përfundime me interes. Komentari “Mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë” pasqyron origjinalitet në zhvillimin individual të bazës ligjore shqyrtuar dhe komentuar mbi produktet e secilit prej autoreve duke bërë të mundur një kohezion material. Vepra “E Drejta Administrative Procedurale” sjell origjinalitet në zhvillimin e jurisprudencës në fushën e së drejtës administrative dhe ka si qëllim vazhdimësinë e trajtesave në lidhje me konceptet e drejtësisë administrative. Teoritë e aktit administrativ dhe dobishmëria e tyre gjejnë një in pakt dhe shtrirje në ndërmarrjen e nismave ligjore, gjithashtu impakti shtrihet për studentët, për praktikantët e së drejtës administrative dhe në veçanti për juristët e administratës publike. Në Kodin e Procedurës Administrative mund të njihesh një analizë e hollësishme për institutet e njohura juridike dhe për institutet të cilat për herë të parë parashikohen në këtë Kod.

24.2 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Origjinaliteti dhe/ose Impakti”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin z. {...} me 5 pikë.

25. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”:

25.1 Për indikatorin “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”, Këshilli vlerësoi se në pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara, rezulton se kandidati mbledh dhe analizon informacione dhe identifikon zgjidhje me anë të zhvillimit logjik të koncepteve ligjore. Kandidati identifikon elementet praktikë dhe juridike të dokumenteve për të cilat ka dhënë mendim e duke analizuar e hulumtuar ia ka arritur të finalizojë botimet e sipërcituara. Kandidati ka identifikuar qartë çështjet ligjore, ka evidentuar problematikat duke dhënë sugjerimet përkatëse, ka përmbledhur parimet dhe standardet, të konkretizuara në veprime konkrete procedurale dhe administrative.

25.2 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin {...} me 5 pikë.

26. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”:

26.1 Për indikatorin “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”, Këshilli vlerësoi se në pesë dokumentet profesionale si dhe në botimet dhe artikujt e tjerë shkencorë, kandidati paraprakisht ka bërë një përcaktim të qartë të problemit, ka zhvilluar në mënyrë logjike konceptet juridike dhe termat teknike. Gjithashtu, gjuha, analizë e mirëfilltë, nxjerr në pah zhvillim logjik dhe kuptueshmërinë e koncepteve juridike.

26.2 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin {...} me 5 pikë.

27. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Interpretimi i harmonizuar”:

27.1 Për indikatorin “Interpretimi i harmonizuar”, Këshilli vlerësoi se në pesë dokumentet profesionale, si edhe në botimet dhe artikujt e tjerë shkencorë, kandidati identifikon dhe interpreton në mënyrë të harmonizuar burimet e ndryshme të së drejtës si dhe tregon dhe argumenton ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e problemit.

27.2 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Interpretimi i harmonizuar”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin {...} me 5 pikë.

28. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Referencat e praktikës gjyqësore”:

28.1 Për indikatorin “Referencat e praktikës gjyqësore”, Këshilli vlerësoi se në botimet, punimet

dhe artikujt e tjerë shkencorë, kandidati trajton dhe referon me efektivitet, në vendin e duhur sipas llojit dhe qëllimit të aktit, praktikën e konsoliduar gjyqësore, praktikën e unifikuar të Gjykatës së Lartë, praktikën e Gjykatës Kushtetuese etj.

28.2 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Referencat e praktikës gjyqësore”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin {...} me 5 pikë.

29. Përfundimisht, sa më sipër, për kriterin e vlerësimit “Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 25 pikë në total.

30. Kriteri i tretë i Kategorisë “Meritat profesionale”, është “Kualifikimi Shtesë Profesional”. Ky kriter vlerësimi ndahet në katër nënkritere, e më konkretisht:

- a) “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike”;
- b) “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike”;
- c) “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit”;
- ç) “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Meritat profesionale-Kualifikimi shtesë profesional”

31. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike”:

31.1 Neni 49, pika 6, shkronja “a”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/2019 dalë në zbatim të ligjit, përcaktojnë si nënkriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe *ekspertizën e veçantë të kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, sipas kërkesave të shpallura për pozicionin e lirë*. Ky përcaktim ligjor, vjen në përputhje me përcaktimet që ka bërë Ligji nr. 98/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 31, pika 1 dhe pika 3, që parashikojnë se: “1. Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ. ...

31.2 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, në mënyrë ideale, Gjykata e Lartë përbëhet nga anëtarë me ekspertizë në fusha të ndryshme të së drejtës, me një veprimtari të njohur profesionale. Fushat e ndryshme të ekspertizës plotësojnë njëra-tjetrën për të pasuruar dhe zgjeruar fushën e aktiviteteve të mbuluara nga Gjykata e Lartë. Për këtë arsye, ky kriter vlerësimi dhe pikëzimi i Kategorisë “Meritat profesionale”, synon të vlerësojë rëndësinë dhe dobinë e specializimit të arritur në përvojën e veçantë profesionale të kandidatit, në mënyrë që të sigurojë “plotësimin e ekspertizës” profesionale dhe të pasurojë kapacitetet profesionale të Gjykatës së

Lartë me profesionistë të spikatur, ndër të tjerë, edhe nga fusha e të drejtës administrative. Vlerësimi i kandidatëve referuar kohëzgjatjes së angazhimit të posaçëm ose të profilizuar në fushën konkrete të së drejtës, bëhet në mënyrë të përshkallëzuar, duke marrë parasysh edhe llojshmërinë e angazhimit në fushën specifike, si lektor i së drejtës, avokat, gjyqtar, këshilltar etj. Ky nënkriter vlerësohet deri në 6 pikë në rastin kur kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike është mbi 15 vjet.

31.3 Kandidati z. {...} ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative e për pasojë, kohëzgjatja e angazhimit të tij në fushën specifike vlerësohet pikërisht në këtë fushë të së drejtës.

31.4 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar, rezultoi se kandidati {...}, deri në momentin e kandidimit, ka një përvojë të gjatë profesionale në fushën e të drejtës administrative, përmbi 23 vjet. Për këtë nënkriter Këshilli merr parasysh edhe llojshmërinë e angazhimit në fushën specifike. Referuar Vendimit nr. 257 datë 12.11.2019, “*Për kualifikimin e kandidatit jogjyqtar z. {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë*” rezultoi se kandidati del të ketë përvojë profesionale deri në momentin e kandidimit si vijon; si avokat - 3 vjet e 3 muaj; si lektor i të drejtës (me kohë të plotë)- 6 vjet e 3 muaj; si jurist i nivelit të lartë në administratën publike - 17 vjet e 8 muaj e 20 ditë; si jurist i nivelit të lartë në fusha të tjera të së drejtës - 1 vit e 7 muaj e 24 ditë, kandidati ka kryer detyrën e prokurorit në Prokuroria Rrethit Vlorë, për periudhën 11.12.1986 - 27.05.1991; *Pedagog në Akademinë e Rendit Publik për periudhën* 16.08 1991- 5.1.1993 - 2 vite e 5 muaj vjetërsi. Në total, kandidati ka përvojë profesionale me kohë të plotë si avokat, si lektor i të drejtës, si jurist i nivelit të lartë në administratën publike dhe si jurist i nivelit të lartë në fusha të tjera të së drejtës përmbi 28 vjet..

31.5 Ndaj nga sa më lart, për nënkriterin e vlerësimit “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike”, janë marrë parasysh përfundimet e arritura nga dokumentacioni i administruar, gjithashtu dhe përgjigjeve të dhëna nga kandidati në seancën e dëgjësës publike, të zhvilluar datë 27.02.2020, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 6 (gjashtë) pikë.

32. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Botime relevante dhe ndikimi i rezultate profesionale në fushën specifike”:

32.1 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, Këshilli cakton deri në 2 pikë për botime relevante në fushën specifike, të tilla si monografi, artikuj në revista shkencore, raporte, udhëzues, komentare etj. Këshilli merr parasysh numrin e botimeve si edhe ndikimin e rezultateve profesionale në atë fushë, si për shembull përdorimin si pjesë e programeve të studimit, në praktikën e institucioneve, si referencë në punimet e autorëve të tjerë. Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë nëse botimet relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale të kandidatit në fushën

specifike janë realizuar në vendet e BE/OECD. Gjithashtu, Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë për impakti e botimeve relevante të kandidatit në zhvillimin e doktrinës dhe të jurisprudencës gjyqësore në këtë fushë.

32.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi që kandidati z. {...} të ketë punuar një sërë botimesh, monografi, artikuj shkencorë, udhëzues në fushën e së drejtës administrative dhe kushtetuese, publikuar në Shqipëri, por edhe jashtë saj, e për këtë u administruan:

1. “E Drejta Administrative Procedurale, Një analizë mbi Kodin e Procedurave Administrative”, botim i vitit 2017;
2. “Gjykata Administrative dhe Kontrolli Ligjor mbi Administratën, një vështrim krahasues mbi drejtësinë administrative” botim i viti 2014;
3. “Drejhtësia Kushtetuese në Zhvillim, trajnime teorike dhe të praktikës së gjykimit kushtetues” botim i vitit 2012;
4. “E drejta Administrative 2” botim i vitit 2008;
5. “E drejta Administrative 2” botim i tretë i ripunuar, i vitit 2005;
6. “Kontrolli Kushtetues” botim i vitit 2004; “Administrata Publike në Ndihmë të Shtetasve” botim i cili është realizuar nga Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)- Cafod Shqipëri dhe financim nga USAID, ku si autor teksti është z. {...};
7. “E Drejta Administrative 2, Teoria e aktit administrativ” botim i dytë i ripunuar;
8. “E drejta Administrative 2, Teoria e Aktit Administrativ” botim i vitit 1999;
9. “Komentar Mbi Reformën Kushtetuese në Sistemin e Drejtësisë” i vitit 2016 në bashkautorësi me një grup autoresh si {...}, {...}, {...}, {...};
10. “E Drejta Administrative, Organizimi dhe Veprimtaria Administrative” Prishtinë 2012 në bashkautorësi me një grup autorësh si {...}, {...};
11. “Gjykata Europiane dhe e Drejta për Jetë Private”, Tiranë 2012 në bashkautorësi me një grup autorësh si {...}, {...}, {...}; “Comparative view of Administrative Law Issues” i vitit 2010 në bashkautorësi me një grup autorësh;
12. “Vështrim Krahasues mbi Procedurën Civile” i vitit 2006 në bashkautorësi me autorët {...};
13. Manual “Guidë Administrative për Njësitë e Qeverisjes Vendore- Disa pyetje të ndeshura shpesh” e vitit 2006 në bashkautorësi me autorët {...}, {...};

14. Komentari "Kodi i Procedurave Administrative" ribotim i plotësuar e vitit 2004 në bashkautorësi me autorët {...}, {...}, {...}. {...}, {...}.

Rezultoi se kandidati gjatë përvojës si gjyqtar pranë Gjykatës Kushtetuese ka përpiluar dhe marrë Vendime më konkretisht:

- Gjykata Kushtetuese Vendimi nr. 29, datë 21.12.2006;
- Gjykata Kushtetuese Vendim nr. 18, datë 14.05.2003;
- Gjykata Kushtetuese Vendimi nr. 25, datë 05.12.2008;
- Gjykata Kushtetuese Vendimi nr. 75, datë 19.04.2002;
- Gjykata Kushtetuese Vendimi nr. 65, datë 10.12.1999

Gjithashtu, rezultoi se kandidati ka punuar dhe botuar edhe një sërë **artikuj shkencorë** në fushën e së drejtës, të botuar në revista shkencore dhe profesionale, konkretisht:

1. *Artikulli mbi veten dhe arritjet profesionale shkruar në revistën " të vërtetat e një Suksesi" Albania Excellence 2017;*
2. *artikulli me temë "Sistemi i centralizuar i kontrollit kushtetues përballë prirjes për decentralizimin e tij" në revistën juridike shkencore të Shkollës së Magjistraturës, Jeta Juridike botim i vitit 2017;*
3. *artikulli me temë " Funksioni i një kushtetute dhe sfidat e saj përballë një realiteti të ri evropian" në periodiket e pavarur Avokatia nr. 9;*
4. *artikulli me temë "Mbi drejtësinë Administrative në Shqipëri" në revistën Akademike Shqiptare të Arteve dhe Shkencave " Academe" vol.3 nr. 1 të vitit 2013;*
5. *artikulli me temë "Pushteti legjislativ i administratës" në periodiket e pavarur Avokatia nr. 6;*
6. *artikulli me temë "Legal Norms as Objects of Constitutional Court Jurisdiction " në Osteuropa recht Gjermani, viti 2012;*
7. *artikulli me temë " Presidentit të Republikës dhe Institucioneve Kushtetuese, në lidhje me Politikën e Sigurisë Kombëtare" botuar në revistën studimore për çështje juridiko-kushtetuese dhe parlamentare "Constitution" e viti 2012, Kosovë;*
8. *artikulli me temë " Kërkimi i Legjitimitetit, një sfidë e përhershme në Gjykatën Kushtetuese" botuar në revistën shkencore Ndërkombëtare "Illyrius" nr.2 të vitit 2012;*
9. *artikulli me temë "Parimet dhe standardet kushtetuese –baza për orientimin e jurisprudencës së Gj. Kushtetuese" në revistën juridike shkencore të Shkollës së Magjistraturës, Jeta Juridike nr. 1 viti i XII i botimit;*
10. *artikulli me temë "Ometimi legjislativ, si çështje specifike për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese" në revistën juridike shkencore të Shkollës së Magjistraturës, Jeta Juridike nr. 1 viti i VII i botimit;*
11. *artikulli me temë " Il controllo della costituzionalità della norma giuridica ed il ricorso del singolo" në botimin e "L'Avvocato del Popolo Albanese" viti 2008 Torino, Itali;*

12. artikulli me temë “ E drejta Kushtetuese , Raporti ndërmjet kushtetutshmërisë dhe politikës ” botuar në revistën shkencore të fakultetit Juridik “Jus & Justicia” nr.1, verë e vitit 2008;
13. artikulli me temë “ Sistemi zgjedhor ndërmjet kushtetutshmërisë dhe politikës ”botuar në revistën “ E drejta Parlamentare dhe Politika Ligjore” nr. 5 e vitit 2007 të Qendrës së Studimeve Parlamentare (QSP/ CPS);
14. artikulli me temë “ E drejta e ankimit nga këndvështrimi i K. PR. Administrative” botuar në revistën 3-mujore të Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, nr. 2 viti XI i botimit ,qershor 2005;
15. artikulli me temë “Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë dhe Jurisprudenca e Gj. Kushtetuese” botuar në revistën “E drejta Parlamentare dhe Politika Ligjore” nr. 1 e vitit 2005 të Qendrës së Studimeve Parlamentare (QSP/ CPS);
16. artikulli me temë “Juridiksi Kushtetues për çështjet që lidhen me procesin zgjedhor dhe me referendumet” botuar në revistën 6 mujore të “Studimeve Juridike” Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë nr. 2 e vitit 2004;
17. artikulli me temë “Përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet mediave dhe gjykatave” në revistën juridike 3-mujore të Shkollës së Magjistraturës, Jeta Juridike nr. 3 botim i vitit 2003;
18. artikulli me temë “Jurisprudenca e Gj. Kushtetuese në frymën e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut ” botuar në revistën “ E drejta Parlamentare dhe Politika Ligjore” nr. 11 e vitit 2003 të Qendrës së Studimeve Parlamentare (QSP/ CPS);
19. artikulli me temë “ Ndryshimet në Kodin zgjedhor – një domosdoshmëri” në revistën juridike 3-mujore të Shkollës së Magjistraturës, Jeta Juridike nr. 1 botim i vitit 2002;
20. artikulli me temë “ Për një kuptim më të drejtë të nocionit kushtetues për një proces të rregullt ligjor” botim me titull “E drejta për një proces të rregullt ligjor” e Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, viti 2002;
21. artikulli me temë “ Koment mbi nenin 98 të Kushtetutës” botuar në revistën 3-mujore të Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut ,nr. 1 viti VIII i botimit ,mars 2002;
22. artikulli me temë “ Roli i Gj. Kushtetuese në mbrojtje të të drejtave të njeriut” botuar në revistën 3-mujore të Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut ,nr. 3 viti VII i botimit ,shtator 2001;
23. artikulli me temë “Kontrolli paraprak i kushtetutshmërisë së normës juridike” botuar në revistën e përtremuajshme nr.1 “ Klinika” e Fondacionit Klinika e Ligjit e vitit 2001;
24. artikulli me temë “Procesi zgjedhor dhe Gj. Kushtetuese” botuar në revistën “ E drejta Parlamentare dhe Politika Ligjore” nr. 4 e vitit 2001 të Qendrës së Studimeve Parlamentare(QSP/ CPS);
25. artikulli me temë “Një vështrim i shkurtër për Kontrollin Kushtetues” botuar në revistën “E drejta Parlamentare dhe Politika Ligjore” nr. 2 e vitit 2001 të Qendrës së Studimeve Parlamentare (QSP/ CPS).

32.3 Nga dokumentet e administruara, rezultoi se kandidati ka një numër të konsiderueshëm botimesh në fushën e së drejtës administrative, të drejtën kushtetuese. Me rëndësi në këtë pikë është libri në bashkautorësi i autorit Komentari, E Drejta Administrative Procedurale, Një analizë mbi Kodin e Procedurave Administrative i cili përbën botimin bazë në kurrikulat universitare në lidhje me Drejtësinë si dhe në Shkollën e Magjistraturës, si dhe një sërë tematikash të trajtuara nga ana e tij dhe në fushën e të drejtës kushtetuese. Kandidati rezulton të ketë edhe botime relevante në vendet e BE/OECD e më konkretisht botimi në revistën shkencore juridike *L'Avvocato del Popolo Albanese* në Torino, Itali artikullin me temë “Il controllo della costituzionalità della norma giuridica ed il ricorso del singolo” ku botimi për kohën ka pasur rëndësinë e vet. Gjithashtu botimin në revistën shkencore juridike Osteuropa recht në Gjermani, me temë “ Legal Norms as Objects of Constitutional Court Jurisdiction ”.

32.4 Ndaj nga sa më lart, për nënkriterin e vlerësimit “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike”, duke pasur parasysh numrin e botimeve të kandidatit në fushën specifike, si dhe ndikimin e tyre në Shqipëri e më gjerë, Këshilli çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 6 pikë.

33.Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit”:

33.1 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, Këshilli cakton deri në 4 pikë për konsulencën në fushën përkatëse të së drejtës si edhe për kontributet në hartimin e legjislacionit, bazuar në të dhëna të dokumentuara. Këshilli vlerëson rolin, sasinë dhe cilësinë e angazhimit, dhe ndikimin në veprimtarinë specifike. Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë për shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit duke vlerësuar nëse konsulencën në fushën përkatëse të ligjit është realizuar në vendet e BE/OECD.

33.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka qenë konsulent dhe ka kontribut real në hartimin e legjislacionit dhe për këtë u administruan:

1. Analiza dhe Strategjia e “Reformës në Sistemin e Drejtësisë” Botim i Kuvendit të Shqipërisë Vëllimi I, mbështetur nga SOROS viti 2017;
2. Pjese e grupit e punës së ngritur nga Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë nr. 12. datë 02.04.2015 i miratuar nga Kuvendi;
3. Prezantimi i Analizës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, qershor 2015; Debati Kushtetues i “Reformës në Sistemin e Drejtësisë” Botim i Kuvendit të Shqipërisë Vëllimi II;
4. Përmbledhja e takimeve dhe diskutimeve me teme” Debat mbi modulën kushtetues dhe ndryshimet kushtetuese me grupet e punës” viti 2015;
5. Procesverbale të Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë për miratimin e projektit final të ndryshimeve kushtetuese mbajtur nga Kuvendi i Shqipërisë. viti 2016;

6. Përmbledhje e takimeve dhe konsultimet me publikun për çështjet kushtetuese të Reformës në Drejtësi.

33.3 Sipas këtyre të dhënave, kandidati ka dhënë konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit administrativ dhe kushtetues Shqiptar, në përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të standardeve të KEDNJ, në hartimin e programeve në kuadër të Programit të Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, si dhe hartimin e akteve në kohën kur ka qenë në pozicionit e rektorit në universitet. Roli i kandidatit ka qenë shumë i rëndësishëm, ku me Reformën në Drejtësi, ai ka pasur edhe cilësinë e Bashkëkryetar i nën komisionit për Reformën Kushtetuese dhe Gjykatën Kushtetuese.

33.4 Ndaj nga sa më lart, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar gjithashtu dhe përgjigjeve të dhëna nga kandidati në seancën e dëgjësës publike, të zhvilluar datë 27.02.2020, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me nënkriterin “*Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit*”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati me 4 pikë.

34. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”:

34.1 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit ky nënkriter është zbërthyer në tre tregues, e konkretisht:

- i) “Pjesëmarrje në konferenca shkencore”;
- ii) “Mësimdhënie”
- iii) “Çmime dhe tituj”

34.2 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, Këshilli vlerëson në veçanti edhe referimet në konferenca shkencore kombëtare, në fushën specifike të specializimit, bazuar në fjalimet e dorëzuara, dhe cakton deri në 2 pikë, duke marrë parasysh numrin e referimeve dhe rolin e referuesit. Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë nëse referimet në fushën specifike - të dokumentuara nga fjalimet e dorëzuara nga kandidati - janë realizuar në konferenca shkencore ndërkombëtare në vendet e BE/OECD, duke marrë parasysh numrin e referimeve dhe rolin e referuesit. Këshilli vlerëson edhe përvojën e mësimdhënies, në fushën specifike të specializimit, për profesionistët (për shembull gjyqtarët, prokurorët, avokatët etj.), dhe duke marrë parasysh numrin e angazhimeve, kohëzgjatjen, institucionin, rolin si mësimdhënës/trajnuës, cakton deri në 4 pikë. Për përvojën si pedagog, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme ose si "profesor vizitor/personel akademik i ftuar", në fushën specifike të specializimit, në vendet e BE/OECD, Këshilli cakton deri në 2 pikë. Kandidatit i caktohen gjithashtu deri në 2 pikë për çmime ose tituj të veçantë nderi në vendet e BE/OECD.

34.3 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Pjesëmarrje në konferenca shkencore”:

34.3.1 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka një sërë pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit, provuar këto me referimet përkatëse, ku për këtë u administruan:

1. pjesëmarrja në konferencën shkencore ndërkombëtare me temë “ Europeanization of Constitutional Law and Constitutionalization of European Law Challenges for the Future” organizuar nga Gjykata Kushtetuese në bashkëpunim me {...} në Tiranë viti 2018;
2. pjesëmarrja në konferencën shkencore ndërkombëtare me temë “Magjistratura në Perspektivën Evropiane” organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me partneret ndërkombëtar dhe OJF në Tiranë viti 2017;
3. pjesëmarrja në konferencën shkencore me temë “Kushtetuta si Instrument Qëndrueshmërie dhe Zhvillimi” organizuar nga Gjykata Kushtetuese në bashkëpunim me {...} në Tiranë viti 2013;
4. pjesëmarrja në konferencën me temë “Gjyqtari në Demokraci” botuar në revistën juridike të Shkollës së Magjistraturës, Jeta Juridike nr. 2 botim i vitit 2016;
5. pjesëmarrja në konferencën shkencore me temë “ Studim : Mbi mundësitë e amendimit të ligjit nr. 8577 datë 10.02.2000 Për Organizimin dhe Funksionimin e Gj. Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur në Shqipëri SOROS në tetor 2011-Janar 2012;
6. pjesëmarrja në konferencën shkencore me temë “Takim mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë” mbajtur në Gjenevë në mars 2002;
7. pjesëmarrja në konferencën kombëtare me temë “E Drejta e Jetës e Drejtë Universale- Shteti dhe Shoqëria Civile në Mbrojtje të drejtës së Jetës”, organizuar nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me Fondacionin ZKPM në vitin 2001 Tiranë;

34.3.2 Sipas dokumenteve të administruara, kandidati z. {...} ka pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, të zhvilluar në Shqipëri, si dhe në vendet e BE-së, konkretisht, Gjermani, Itali dhe Gjeneve. Këto pjesëmarrje të kandidatit, provohen me referimet që ai ka bërë, të cilët janë publikuar në revista të ndryshme juridike, ku rezulton se referimet e kandidatit janë në fushën e të drejtës kushtetuese , në të drejtën administrative apo aspekteve të tjera si e drejta e jetës si e drejtë universale etj.

34.3.3 Ndaj nga sa më lart, për treguesin “Pjesëmarrje në konferenca shkencore”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 4 pikë.

34.4 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Mësimdhënie”:

34.4.1 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka përvojë të gjatë në mësimdhënie për profesionistët e së drejtës, provuar kjo me referimet përkatëse ose dokumentacion tjetër provues, kryesisht në Shkollën e Magjistraturës dhe për këtë u administruan:

1. Shkresë nr.906 prot., datë 19.11.2019 nga Shkolla e Magjistraturës për vlerësimin e marra në rolin e ekspertit në kuadër të programeve dhe trajnimeve të zhvilluara pranë këtij institucioni në lidhje me Programin e Formimit Fillestar Vazhdues.
2. Shkresë nr. 719/1 prot., datë 02.09.2019, Shkolla e Magjistraturës, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4229/9 prot., datë 03.09.2019 nga rezultoi se kandidati është angazhuar si pedagog i jashtëm në Programin e Formimit Fillestar dhe si ekspert në Programin e Formimit Vazhdues nga viti 1997 e deri në vitin 2014, dhe si Drejtor i Shkollës së Magjistraturës, nga viti 2014 e në vazhdim në lëndën “E drejta Administrative”.
3. Shkresë nr. 1852/1 prot., datë 09.09.2019, Akademia e Sigurisë, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4229/13 prot., datë 10.09.2019 nga rezultoi se kandidati ka punuar pranë Akademisë së Rendit Publik, Pedagog në Katedrën Juridike, në periudhën 01.10.1992 - 05.01.1993 në lëndën “E drejta Administrative”.
4. Shkresë nr. 240/1 prot., datë 09.09.2019, Universiteti Evropian i Tiranës, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4229/14 prot., datë 11.09.2019 nga rezultoi se kandidati ka punuar si pedagog për lëndët, “E drejta Administrative” “Çështje të drejtësisë kushtetuese” dhe “Kontrolli i ligjshmërisë së aktit”.
5. Shkresë nr. 3996/3 prot., datë 20.11.2019 protokolluar nga Këshilli, në kuadër të dokumentacioneve të paraqitura, bazuar në rekomandimin e përcjellë nga Universiteti “Luarasi” për veprimtarinë si Rektor për periudhën 2013-2014 pranë Kolegjit Universitar “Luarasi” në ato vite dhe për veprimtarinë si pedagog pranë Fakultetit të Drejtësisë.

34.4.2 Sipas dokumenteve të administruara, gjithashtu, referuar jetëshkrimit rezultoi që z. {...} se ka një përvojë të konsiderueshme në mësimdhënie që nga viti 1992-e në vijim, kryesisht në fushën specifike për pozicionin e lirë, atë të së drejtës administrative, por edhe në fusha të tjera, si çështje të drejtësisë kushtetuese apo kontrolli i ligjshmërisë së aktit. Kandidati ka qenë dhe është pedagog/drejtues pranë Shkollës së Magjistraturës për studentët për në Formimin Fillestar, si dhe në cilësinë e ekspertit/udhëheqësit, ku trajnon profesionistët e së drejtës, magistratët në kuadër të Formimit Vazhdues. Ky fakt u evidentua nga kandidati edhe gjatë intervistës përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nga dokumentacioni i administruar për kandidatin nuk rezultoi ndonjë përvojë si pedagog me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme ose si “profesor vizitor/personel akademik i ftuar” në fushën e të drejtës administrative, në vendet e BE/OECD.

34.4.3 Ndaj nga sa më lart, për treguesin “Mësimdhënie”, duke pasur parasysh kohëzgjatjen, institucionin, rolin si mësimdhënës/trajnuës të kandidatit, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se ai duhet të vlerësohet me 4 pikë.

34.5 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Çmime dhe tituj”:

34.5.1 Nga dokumentacioni i administruar për kandidatin z. {...} rezultoi që më datë 16 dhjetor 2015 është nderuar me titullin “Albanian Excellence- Histori Suksesi 2015 për profesionalizëm, përkushtim dhe maturinë e treguar në zhvillimin dhe pasurimin e jurisprudencës dhe të çështjeve që lidhen me reformimin e drejtësisë shqiptare” duke u pajisur me dokumentin “Diplomë Nderi”. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit për këtë nënkriter kandidati vlerësohet nëse çmimi dhe titulli i marrë është dhënë në vendet e BE/OECD.

34.5.2 Ndaj nga sa më lart, për treguesin “Çmime dhe tituj”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 0 pikë.

34.6 Për rrjedhojë, për nënkriterin e vlerësimit “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 8 pikë në total.

35. Përfundimisht, sa më sipër, për kriterin e vlerësimit “Kualifikimi shtesë profesional”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 24 pikë në total.

36. Kategoria e dytë e vlerësimit është “Meritat morale dhe etike”. Kjo kategori vlerësimi ndahet në tre kritere, e më konkretisht:

- 1) “Shmangia e shfaqjes së pahijshme”;
- 2) “Nderi dhe dinjiteti”;
- 3) “Reputacioni”.

37. Neni 136, pika 3, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton se: “3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur...”. Nga interpretimi i dispozitave kushtetuese, por dhe i atyre të ligjit të posaçëm, lex specialis, rezulton se ligji material ka përçuar qëllimin e Kushtetutbërësit për transformimin e Gjykatës së Lartë “në një gjykatë karriere” përmes vendosjes së kritereve transparente për emërimin e gjyqtarëve nga të dy kategoritë (gjyqtarë dhe jogjyqtarë/juristë të spikatur)”, për të garantuar një përbërje cilësore jo

vetëm nga pikëpamja profesionale, por mbi të gjitha edhe të integritetit të figurës. Për pasojë, përmes kuadrit rregullator në tërësi, nëpërmjet kritereve të vendosura, është synuar identifikimi i juristëve të aftë profesionalisht dhe me integritet të lartë moral, pasi në suksesin e vërtetë të një Gjykate të Lartë ndikojnë sa dijet ligjore të gjyqtarëve, aftësia e tyre për të ushtruar që në fillim disiplinë doktrinare, por po aq të rëndësishme janë edhe cilësitë dhe integriteti tyre, në mënyrë që të kontribuojnë në pavarësinë e gjykatës, për ta bërë atë të pathyeshme ndaj çdo lloj sulmi apo fenomeni negativ që e cenon atë.

38. Sipas Vendimit 102/2019 dhe Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kategori bazohet në atë nëse kandidati miraton, respekton dhe mbështet vlerat themelore të punës së pritshme të gjyqtarit, siç janë (1) shmangja e shfaqjes së pahijshme, (2) nderi dhe dinjteti, dhe (3) reputacioni, duke demonstruar cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë. Kandidati duhet të jetë i vetëdijshëm se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut. Vlerësimi dhe pikëzimi i kësaj kategorie vlerësimi, sipas kritereve më sipër, bëhet sipas një rendi zbritës, duke supozuar se kandidati ka integritet etik dhe moral të plotë. Mbi këtë qasje, kandidati e fillon procedurën e vlerësimit me totalin e pikëve referuar secilit kriter të kësaj kategorie vlerësimi, dhe nëse burime të provuara dhe të besueshme evidentojnë një mangësi në lidhje me integritetin moral dhe etik, Këshilli cakton për kandidatin minimumin e pikëve (1 pikë). Të dhënat për vlerësim dhe pikëzim të kandidatit janë ato që rezultojnë nga gjetjet në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit apo nga informacione të tjera të verifikuara nga Këshilli.

39. Për kandidatin {...}, gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, nuk rezultoi asnjë gjetje negative në raport me figurën, referuar treguesve respektivë për secilin kriter të kësaj kategorie vlerësimi. Po ashtu, për kandidatin, gjatë gjithë procesit të kandidimit nuk rezultoi ndonjë informacion tjetër negativ në lidhje me figurën, referuar treguesve respektivë për secilin kriter të kësaj kategorie vlerësimi.

40. Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} të jetë person që gëzon integritet dhe moral të plotë, ku për këtë u administruan:

1. Shkresë nr.906 prot., datë 19.11.2019 nga Shkolla e Magjistraturës për vlerësimin e marra në rolin e ekspertit në kuadër të programeve dhe trajnimeve të zhvilluara pranë këtij institucioni në lidhje me Programin e Formimit Fillestar Vazhdues.

2. Shkresë nr. 719/1 prot., datë 02.09.2019, Shkolla e Magjistraturës, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4229/9 prot., datë 03.09.2019 nga rezultoi se kandidati është angazhuar si pedagog i jashtëm në Programin e Formimit Fillestar dhe si ekspert në Programin e Formimit Vazhdues nga viti 1997 e deri në vitin 2014, dhe si Drejtor i Shkollës së Magjistraturës, nga viti 2014 e në vazhdim, për kandidatin nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore;

3. Shkresë nr. 3996/3 prot., datë 20.11.2019 protokolluar nga Këshilli, në kuadër të dokumentacioneve të paraqitura, kandidati {...} ka sjellë si përvojë profesionale vendime të Gjykatës Kushtetuese.

4. Shkresë nr. 281/1 prot., datë 04.09.2019, Gjykata Kushtetuese, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4229/12 prot., datë 06.09.2019 nga rezultoi se kandidati ka qenë në funksionin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese nga muaji prill i vitit 1998, deri në muajin korrik të vitit 2011 dhe për kandidatin nuk është regjistruar asnjë masë disiplinore apo administrative;

5. Shkresë nr. 2153/48 prot., datë 02.10.2019, Prokuroria e Përgjithshme, protokolluar në Këshill me të cilën është përcjellë Vendimi “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin {...}”, nga rezultoi se ndaj kandidatit nuk është regjistruar ndonjë kallëzim, nuk janë kryer referime, nuk ka qenë apo është në hetim për kryerjen e ndonjë vepre penale dhe nuk i është caktuar ndonjë masë shtrënguese e sigurisë personale. Ai nuk figuron i ndaluar/arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e ndonjë vepre penale. Nuk ka të dhëna ose indicie për veprimtari kriminale;

6. Shkresa nr. 1177/4 prot., datë 12.09.2019, e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me të cilën është përcjellë Vendimi nr. nr.565 datë 10.09.2019, i këtij Autoriteti, sipas të cilit, nga të gjitha verifikimet e kryera, nuk rezulton që kandidati të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, nuk rezulton të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991

7. Shkresë nr. 1852/1 prot., datë 09.09.2019, Akademia e Sigurisë, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4229/13 prot., datë 10.09.2019 nga rezultoi se kandidati ka punuar pranë Akademisë së Rendit Publik, Pedagog në Katedrën Juridike, në periudhën 01.10.1992 - 05.01.1993 dhe nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore;

8. Shkresë nr. 2313/1 prot., datë 04.09.2019, Shoqëria INSIG sh.a, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4229/11 prot., datë 04.09.2019 nga rezultoi se kandidati ka punuar pranë Shoqërisë INSIG sh.a (Instituti i Sigurimeve), në pozicionin e juristit, në periudhën 08.01.1993 - 01.09.1994 dhe për të nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore;

9. Shkresë nr. 382 prot., datë 02.09.2019, Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4229/10 prot., datë 04.09.2019 nga rezultoi se për kandidatin ka fituar titullin avokat dhe është mbajtës i licencës nr. 193, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, përpara vitit 2000, periudhë për të cilën nuk disponojmë dokumentacion, pasi deri në atë periudhë avokatia ka pasur vartësi nga Ministria e Drejtësisë. / ... për periudhën pas këtij viti subjekti në fjalë figuron në regjistrin e avokatëve pasiv të Republikës së Shqipërisë për shkak të papajftueshmërisë ligjore për

ushtrimin e profesionit të avokatit, parashikuar sipas nenit 7 të ligjit 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, pasi ka ushtruar funksione pranë administratës publike;

10. Shkresë nr. 2520/1 prot., datë 27.09.2019, Prokuroria e Përgjithshme informon se kandidati “ka kryer detyrën e Prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Vlorë, për periudhën 11.12.1986 - 27.05.1991” dhe për të nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore;

11. Shkresë nr. 240/1 prot., datë 09.09.2019, Universiteti Europian i Tiranës, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4229/14 prot., datë 11.09.2019 nga rezultoi se për kandidatin nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore;

12. Shkresë nr. 3996/3 prot., datë 20.11.2019 protokolluar nga Këshilli, në kuadër të dokumentacioneve të paraqitura, bazuar në rekomandimin e përcjellë nga Universiteti “Luarasi” për veprimtarinë si Rektor për periudhën 2013-2014 pranë Kolegjit Universitar “Luarasi” në ato vite dhe për veprimtarinë si pedagog.

41. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme”:

41.1 Sipas dokumentacionit të administruar, nisur nga të dhënat që rezultuan nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim si anëtar për në Gjykatën e Lartë, intervista me kandidatin, komunikimi i tij gjatë gjithë procedurës së përzgjedhjes, si dhe referuar dokumenteve të tjerë, përfshirë ato të aksesueshme publikisht, si dhe në mungesë të ndonjë të dhënë të ardhur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor gjatë kohës që procedura e përzgjedhjes ishte bërë publike edhe nëpërmjet medias, për kriterin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme”, nuk rezultoi që kandidati të ketë treguar mungesë respekti, vetëpërmbytje, ndjeshmërie, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive. Po ashtu, nuk rezultoi që kandidati: të ketë tejkalime dhe ekstravagancë në ushtrimin e profesionit; të ushtroj apo të ketë ushtruar në të kaluarën profesionin me njëanshmëri; të ketë kërkuar nëpërmjet ndërhyrjes, që të përfitojë një avantazh të pamërituar për veten ose për të tjerët: të ketë pranuar dhurata ose avantazhe për veten ose për të afërmit, kur ushtron detyrën ose profesionin. Gjithashtu, edhe gjatë intervistës së zhvilluar, kandidati tregoi një sjellje dhe komunikim etik, duke treguar respekt dhe vetëpërmbytje.

41.2 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Shmangia e shfaqjes së pahijshme”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 5 pikë.

42. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Nderi dhe dinjteti”:

42.1 Sipas dokumentacionit të administruar, si dhe referuar çdo të dhënë tjetër që ka rezultuar për indikatorët si më sipër, në lidhje me kriterin “Nderi dhe dinjteti”, rezultoi që kandidati transmeton vlera personale dhe profesionale, ndërkohë që nuk rezultoi nga burimet e vlerësimit dhe as nga ndonjë e dhënë tjetër, që kandidati të ketë sjellje të tilla që i kundërshtojnë këto të dhëna. Nuk rezultoi ndonjë e dhënë sipas të cilës kandidati: të karakterizohet nga mungesa e vëmendjes dhe

interesimit për respektimin dhe dinjitetin e individëve: shpërdoron fondet publike, keqpërdor kohën e punës, personelin dhe burimet për qëllime private: të shfaqë sjellje të bullizmit, frekuentim të dobët në punë apo përdorim të substancave të ndaluara. Përkundrazi, referuar dokumentacionit të administruar, opinioneve vlerësuese të drejtuesve të institucioneve, subjekteve dhe organizatave si më lart, ku kandidati ka marrë pjesë, ai reflekton vlera personale dhe profesionale, është një shembull për kolegët e tij si dhe për studentët, ndërkohë që opinionet e dhëna vënë theksin të integriteti i tij, të sjellurit me nder dhe dinjitet.

42.2 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Nderi dhe dinjiteti”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 5 pikë.

43. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Reputacioni”:

43.1 Sipas dokumentacionit të administruar, si dhe referuar çdo të dhënë tjetër që ka rezultuar nga indikatorët si më sipër, në lidhje me kriterin “Reputacioni”, rezultoi që kandidati shfaq arritje mbi nivelin e etikës dhe cilësive morale gjatë përvojës në punë, ndërkohë që nuk rezultoi nga burimet e vlerësimit dhe as nga ndonjë e dhënë tjetër, që kandidati të ketë shfaqur sjellje të tilla që nuk përmbushin pritshmëritë e qytetarëve dhe të shoqërisë në lidhje me cilësitë profesionale të gjyqtarit, të tilla si: rezerva dhe diskrecioni, kujdesi dhe respekti, si dhe cilësitë personale si: mençuria, besnikëria, humanizmi, serioziteti dhe matura. Gjithashtu, Këshilli konsideroi përgjigjen e dhënë nga kandidati në pyetjen e parashtruar nga njëri prej anëtarëve të Këshillit, se cila kishte qenë dilema etike më e madhe me të cilën ai është ndeshur dhe sesi e kishte zgjidhur atë, kandidati parashtroi një situatë, ku ai kishte pasur dilemë apo sfida, dhe zgjedhjet që ai kishte bërë ishin përtej interpretimit personal dhe atij profesional, por deklaroi se e kishte parë veten si profesionist i së drejtës e për rrjedhojë duhej të jepte kontribut përkatës, sikurse edhe kërkon ta japë edhe tani nëpërmjet kandidimit për në Gjykatën e Lartë.

43.2 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Reputacioni”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 5 pikë.

44. Kategoria e tretë e vlerësimit është “Meritat organizative dhe menaxheriale”. Kjo kategori vlerësimi ndahet në katër kritere, e më konkretisht:

- 1) “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur”;
- 2) “Aftësitë vendimmarrëse”;
- 3) “Aftësitë e komunikimit”;
- 4) “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore”.

45. Referuar nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në lidhje me emërimet në Gjykatën e Lartë, ndër të tjera, përcaktohet se: “...*Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur...*”. Sipas Vendimit 102/2019 dhe Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kategori mban parasysh se gjyqtari duhet të ketë aftësi të mira organizative dhe menaxheriale në mënyrë që të jetë produktiv. Në këtë kuptim, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nuk mund të jetë efektiv pa pasur aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht punën. Produktiviteti, në çdo profesion dhe detyrë, është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mire kandidati përdor kohën e tij, si kur punon vetëm ashtu edhe në grup me të tjerë.

46. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur”:

46.1 Referuar jetëshkrimit, dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, si dhe të dhënave që rezultuan nga intervista me kandidatin, rezultoi se kandidati z. {...} ka një platformë dhe vizion të qartë në lidhje me objektivat nëse zgjidhet anëtar i Gjykatës së Lartë dhe për këtë u administruan:

- Dokumenti përshkruar mbi motivet dhe objektivat nëse emërohet gjyqtar në Gjykatën e Lartë;
- Të dhëna nga intervistimi i kandidatit, më datë 27.02.2020.

46.2 Sipas dokumentit të administruar “Dokumentit përshkruar mbi motivet dhe objektivat nëse emërohet gjyqtar në Gjykatën e Lartë” si dhe intervistës së zhvilluar, Këshilli vlerësoi cilësinë, vlerën dhe origjinalitetin e arsytimit dhe objektivave të prezantuara nga kandidati, ku ai shpalosi programin dhe vizionin e tij mbi qasjen për të realizuar një organizim dhe funksionim cilësor dhe efikas të Gjykatës së Lartë. Këshilli vlerësoi motivet dhe arsyet që e kanë shtyrë kandidatin për të kandiduar për në pozicion vakant pranë Gjykatës së Lartë, që janë pikërisht karriera dhe angazhimi i tij i gjatë, në pozicione të ndryshme si ai i prokurorit, juristit në administratë, avokatit, të gjyqtarit kushtetues, të drejtuesit të lartë në institucionet publike, të hartuesit të ligjeve. Eksperienca afro 28-vjeçare në fushën e të drejtës administrative është një vlerë për kandidatin duke e motivuar atë për të qenë pjese e konkurrimit. Eksperienca 13-vjeçare si anëtarë në Gjykatën Kushtetuese nga ana e kandidatit përben një avantazh dhe vlerë e shtuar duke e ri sjell si një nga motivet e kandidimit. Një nga objektivat që ka parashtruar kandidati në pozicionin e një Gjyqtari të ardhshëm është bërja e një strategjie e cila mungon për këtë Gjykatë. Sipas platformës së kandidimit *Omissis... “Hartimi i një strategjie institucionale afatshkurtër dhe afatgjatë, përshatja e strukturës organizative të Gjykatës së Lartë me nevojat e gjykimit, që paraqiten nga realiteti i ri kushtetues dhe ligjor”..omissis*. Një nga objektivat që kandidati do të ndër marrë në bashkëpunim me anëtarët e tjetër është përpilimi i strategjisë së Gjykatës ku në thelb do të rregulloj dhe përshatë strukturën

e Gjykatës së Lartë, në një situatë ligjore problematike të ndodhur, në lidhje me numrin astronomik të çështjeve. Kjo strategji do të mundësoj, rregulloj dhe lehtësoj në evadimin e çështje të shumta, në kuadër të Njesisë së Shërbimit Ligjor të ngritur tashmë dhe në bashkëpunim me strukturave e tjera administrative të kësaj Gjykatë Sipas platformës se kandidimit *Omissis...* “*Identifikimi i çështjeve ligjore, me përmbajtje të njëjtë në lende, të depozituara për gjykim prej vitesh, krijon mundësinë për marrjen e vendimeve pilot, që unifikojnë praktikën gjyqësore*” *omissis...* Në interviste kandidati parashtroi si objektiv dhe evidentimin e çështjeve në bazë të një lëndë duke evidentuar dhe marrë vendime pilot, në kuadër të situatës e cila ndodhet sot Gjykata e Lartë. “Vendimet pilot” vinë si risi nga ana e kandidatit, këto vendime bëjnë të mundur evadimit e një pjese shumë të mirë të çështje pranë kësaj Gjykate. *Omissis...* “*Ridimensionimi kushtetues i Gjykatës së Lartë, si autoriteti që siguron njehsimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore*” *omissis...* Një tjetër Ridimensionim Kushtetues i Gjykatës së Lartë, duke e bërë këtë të fundit një Gjykatë që unifikon praktikën, në veçanti për çështjen me lëndë “administrative” është objektiv kryesor në funksion të gjithë objektivave të sipërpërmendura. *Omissis...* “*Plotësimi sa më parë i kuadrit rregullator organizativ dhe procedural*” *omissis...* Një tjetër objektiv i parashtruar nga ana e kandidatit është dhe evidentimi i çështjeve në bazë të një lëndë duke evidentuar dhe marrë vendime pilot, në kuadër të situatës e cila ndodhet sot Gjykata e Lartë. “Vendimet pilot” vinë si risi nga ana e kandidatit, këto vendime bëjnë të mundur evadimit e një pjese shumë të mirë të çështje pranë kësaj Gjykate. Ridimensionim Kushtetues i Gjykatës së Lartë, duke e bërë këtë të fundit një Gjykatë që unifikon praktikën, në veçanti për çështjen me lëndë “administrative” është objektiv kryesor në funksion të gjithë objektivave të sipërpërmendura. Gjithashtu kandidati ka përmendur se cilat janë çështjet administrative urgjente për unifikim. Konkretisht shprehet për respektimin e natyrës së pastër kasacionale të Gjykatës së Lartë, duke orientuar praktikën e saj drejt konsolidimit të qëndrimit se rekursi do të pranohet për shqyrtim nga Gjykata e Lartë, jo për çfarëdo lloj shkelje të ligjit procedural dhe material, por vetëm nëse ato janë “të një rëndësie themelore për njehsimin, dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore”. Një tjetër praktike për unifikim është disiplinimi i praktikës gjyqësore, si në rastet e pronave, në lidhje me mosmarrëveshjet për kompetencën lëndore ndërmjet gjykatave civile dhe atyre administrative. Gjykimi mbi aktin normativ dhe individual-konfondim ndërmjet juridiksionit të Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Kushtetuese mbi vlerësimin e pa kushtetutshmërisë/paligjshmërisë së tyre ishte një rast tjetër i shprehur prej tij. Njehsimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i praktikës gjyqësore për çështjet administrative që lidhen me shërbimin civil si dhe njehsimi i praktikës gjyqësore lidhur me kontrollin gjyqësor mbi diskrecionin e organit për rastet e shpronësimit publik dhe të metodologjisë për vlerësimin e masës së shpërblimi, janë pikat e fundit të shprehura për unifikimin nga ana e kandidatit. *Omissis...* “*Përmirësimi i marrëdhënieve të Gjykatës së Lartë me publikun; Riaktivizimi i veprimtarive profesionale dhe shkencore të organizuara nga Gjykata e Lartë; Qasja me pro aktivë ndaj zhvillimit të teknologjisë së informacionit*” *omissis...* Në objektivat e synimet e kandidatit u reflektua dhe rëndësia e një rregullore të brendshme për të

ndihmuar në mbarëvajtjen e punës së gjyqtarëve të kësaj Gjykate. Rëndësi të veçantë kandidati i dha përmirësimit të marrëdhënies së Gjykatës me median dhe publikun, duke vlerësuar rolin e magistratit me median, qenia me transparente e veprimtarisë së Gjykatës së Lartë, publikimin e vendime më të qarta dhe aksesueshmëri nga ana e publikut. Në pikën e fundit të objektivave kandidati parashtron riaktivizimi e veprimtarive profesionale me qëllim shkëmbimin e informacioneve dhe zhvillimeve më të reja të praktikës dhe të doktrinës juridike, si dhe qasjen me teknologjinë e informacionit.

46.3 Nga sa rezultoi, Këshilli vlerësoi: kuptimin e thellë që kandidati ka për rolin e tij si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, sikundër edhe për rolin e kësaj gjykate; vizionin e kandidatit në lidhje me sfidat kryesore me të cilat përballet Gjykata e Lartë, si nga perspektiva organizative, ashtu edhe e çështjeve thelbësore të së drejtës, si dhe mendimet dhe sugjerimet konkrete të kandidatit për t'i adresuar këto sfida.

46.4 Ndaj nga sa më lart, për kriterin e vlerësimit “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 2 pikë.

47. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë vendimmarrëse”:

47.1 Referuar jetëshkrimit, dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, si dhe të dhënave që rezultuan nga intervista me kandidatin, rezultoi se kandidati z. {...} ka aftësitë të fituara në përvojën, pozicionet dhe përgjegjësitë e mbuluara, në lidhje me aspektet që kanë të bëjnë me menaxhimin, planifikimin dhe administrimin e punës dhe për këtë u administrua dokumentacioni që ka të bëjë me:

1. Puna dhe eksperiencia si pedagog / drejtor/ anëtar këshilli/ kryetar i këshillit pedagogjike në Shkollën e Magistraturës. – Puna dhe aftësitë evidentohen edhe nga fakti që ka qenë pedagog që nga krijimi i Shkollës së Magistraturës, fillimisht pedagog i brendshëm dhe më pas i jashtëm në formimin fillestar, ekspert në trajnimet e formimit vazhdues

2. Puna si Anëtar i Bordit të Revistës “Jeta Juridike” të Shkollës së Magistraturës nga viti 2014 e në vijim.

3. Pjesëmarrja si ekspert i nivelit të lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar në Kuvendin e Shqipërisë për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. - Vlerësimi i punës paraqitet edhe në Dokumentet e Kuvendit të Shqipërisë për Reformën në Sistemin e Drejtësisë.

4. Pjesëmarrja si Bashkëkryetar i nën komisionit për Reformën Kushtetuese dhe Gjykatën Kushtetuese.

5. Pjesëmarrja në Bordin Editorial për Botimin e Kuvendit të Shqipërisë “Reforma në Sistemin e Drejtësisë”. Vlerësimi i punës paraqitet edhe në Dokumentet e Kuvendit të Shqipërisë (të Bordit Editorial) për Reformën në Sistemin e Drejtësisë.

6. Pjesëmarrja në përgatitjen e Raportit me teme “Ekzekutimi i Vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe roli i rëndësishëm i tyre në forcimin e shtetit të së drejtës” mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur në Shqipëri SOROS në vitin 2008;

7. Veprimtaria si Anëtar i Asamblesë së Komitetit Shqiptar të Helsinkit që nga viti 2011 e në vijim

8. Puna si Rektor në Universitetin Jopublikë “Luarasi”

9. Veprimtaria si Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese për një periudhë 13-vjeçare.

10. Veprimtaria si Zëvendës President i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Shqipërisë në vitin 2015 si President i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Shqipërisë në vitin 2018.

11. Veprimtaria si Anëtar i Bordit të Revistës juridike “Avokatia” nga viti 2011 e në vijim.

12. Veprimtaria si Anëtar i Bordit të Administratës Publike pranë Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” në vitet 2001-2005.

13. Veprimtaria si Liaison officer ndërmjet Komisionit të Venecias dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë në vitet 2000-2005.

14. Veprimtaria si Anëtar i Bordit të Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut në vitet 2004-2005.

15. Veprimtaria si Anëtar i Bordit të Revistës “E drejta parlamentare dhe politikat ligjore” në vitet 2002-2005.

47.2 Sipas dokumenteve të administruara, rezultoi se kandidati {...} ka pasur pozicione të ndryshme pune si pedagog, gjyqtar, konsulent, rektor, anëtar bordi, ekspert për çështje të së drejtës administrative dhe kushtetuese etj. Duke pasur në konsideratë edhe përgjegjësitë që ai ka mbuluar në këto pozicione të ndryshme dhe të rëndësishme edhe në jetën publike, Këshilli vlerësoi se kandidati paraqet aftësi shumë të mira menaxhuese, planifikuese dhe në administrimin e punës. Këshilli në këtë pikë, mbajti në konsideratë edhe faktin se kandidati ka mbajtur dhe mban pozicione drejtuese, ku aftësitë vendimmarrëse shpalosen më shumë. Gjithashtu, gjatë intervistës, kandidati tregoi vendosmëri në lidhje me çështje të ndryshme që kishin nevojë për zgjidhje për funksionimin sipas ligjit të Gjykatës së Lartë, duke theksuar nismat dhe vendimmarrjet që duhet të merreshin në kuadër të “backload”-it të Gjykatës së Lartë, në kuadër të organizimit dhe përmirësimit të burimeve njerëzore dhe stafit ndihmës si dhe shndërrimin e saj në një Gjykatë që

“Gjykatë Ligji”, që jep vendime të arsyetuara, unifikuara dhe bindëse, cilësi këto që vendosin një siguri në rendin juridik dhe siguri për opinionin publik.

47.3 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Aftësitë vendimmarrëse”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 4 pikë.

48. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë e komunikimit”:

48.1 Referuar jetëshkrimit, dokumentacionit të administruar gjatë procedurës të cilat shërbyen edhe për vlerësimin e kriterit “Aftësitë vendimmarrëse”, si dhe të dhënave që rezultuan nga intervista me kandidatin, rezultoi se kandidati z. {...} ka aftësi shumë të mira për t’u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize. Këshilli vlerëson gjithashtu, edhe nëse kandidati është në gjendje të komunikojë me subjektet e tjera dhe të tretët në mënyrë jo diskriminuese, të matur dhe me respekt. Për këtë kriter, kandidati u vlerësua mbi bazën e të njëjtit dokumentacion që u vlerësua për kriterin “Aftësitë vendimmarrëse” si dhe të dhënat që rezultuan nga dëgjesa me kandidatin. Referuar të dhënave të dokumentuara si dhe dëgjësës së zhvilluar me kandidatin, ai rezultoi të ketë punuar në pozicione të ndryshme, ka qenë pjesëmarrës në projekte të ndryshme dhe këto të dhëna të marra në tërësi, së bashku me referencat e përcjella nga drejtues të institucioneve dhe organizatave të ndryshme ku kandidati punon apo ka punuar, tregojnë se ai komunikon me të tretët në mënyrë jo diskriminuese, të matur dhe me respekt.

48.2 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Aftësitë e komunikimi”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 2 pikë.

49. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore”:

49.1 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka vijueshmëri në punë të zhvilluara në ekip dhe punë në ambiente multidisiplinore dhe për këtë u administrua dokumentacioni që ka të bëjë me pjesëmarrjet si:

1. Pjesë e grupit e punës së ngritur nga Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë nr. 12. datë 02.04.2015 i miratuar nga Kuvendi;
2. Pjesë e grupit e punës në përgatitjen e Raportit me teme “Situata e diskriminimit në procesin e largimit nga puna në Shqipëri”, raport i hartuar në mbështetje të Civil Rights Defenders dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit në vitin 2011;
3. Pjesë e grupit e punës në Bordin Editorial për Botimin e Kuvendit të Shqipërisë “Reforma në Sistemin e Drejtësisë”. Vlerësimi i punës paraqitet edhe në Dokumentet e Kuvendit të Shqipërisë (të Bordit Editorial) për Reformën në Sistemin e Drejtësisë;

4. Pjesë e grupit e punës në përgatitjen e Raportit me teme “Ekzekutimi i Vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe roli i rëndësishëm i tyre në forcimin e shtetit të së drejtës” mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur në Shqipëri SOROS në vitin 2008;

5. Puna dhe eksperiencia si Pedagog / Drejtor/ Anëtar Këshilli/ Kryetar i këshillit pedagogjike në Shkollën e Magjistraturës;

6. Pjesë e grupit e punës si Anëtar i Bordit të Revistës “Jeta Juridike” të Shkollës së Magjistraturës nga viti 2014 e në vijim;

7. Pjesë e grupit e punës si ekspert i nivelit të lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar në Kuvendin e Shqipërisë për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. - Vlerësimi i punës paraqitet edhe në Dokumentet e Kuvendit të Shqipërisë për Reformën në Sistemin e Drejtësisë;

8. Pjesë e grupit e punës si Bashkëkryetar i nën komisionit për Reformën Kushtetuese dhe Gjykatën Kushtetuese;

Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar, rezultoi se kandidati ka kryer veprimtarinë në fusha të tjera si me poshtë:

9. Veprimtaria si Anëtar i Asamblesë së Komitetit Shqiptar të Helsinkit qe nga viti 2011 e në vijim;

10. Puna si Rektor në Universitetin Jopublik ”Luarasi”;

11. Veprimtaria si Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese për një periudhë 13-vjeçare;

12. Veprimtaria si Zëvendës President i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Shqipërisë në vitin 2015 si President i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Shqipërisë në vitin 2018;

13. Veprimtaria si Anëtar i Bordit të Revistës juridike “Avokatia” nga viti 2011 e në vijim;

14. Veprimtaria si Anëtar i Bordit të Administratës Publike pranë Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” në vitet 2001-2005;

15. Veprimtaria si Liaison officer ndërmjet Komisionit të Venecias dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë në vitet 2000-2005;

16. Veprimtaria si Anëtar i Bordit të Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut në vitet 2004-2005;

17. Veprimtaria si Anëtar i Bordit të Revistës “E drejta parlamentare dhe politikat ligjore” në vitet 2002-2005;

49.2 Sipas dokumenteve të administruara, rezultoi se kandidati ka mbi 28 vjet pune, gjatë së cilës

në vijimësi ka pasur eksperiencë pune në grup dhe në ambiente multidisiplinore, çka tregon se ai ka aftësitë e nevojshme për të punuar në kolegje sikurse Gjykata e Lartë funksionon. Duke vlerësuar se ai ka punuar shpesh në ambiente multidisiplinore dhe punë në grup, referuar edhe vlerësimeve të përcjella nga drejtuesit e institucione përkatëse që kanë vlerësuar punën, kompetencat dhe aftësitë e kandidatit për të punuar në grup, si dhe duke pasur në konsideratë faktin se ai është promovuar shpesh në projekte të ndryshme edhe me ndërkombëtarët, Këshilli çmoi se kandidati është i përshtatshëm për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, pasi reflekton kompetencë dhe aftësi për të punuar në kolegje me gjyqtarë të tjerë, për të shkëmbyer lirshëm dhe në mënyrë efektive pikëpamjet me kolegët dhe disponueshmërisë për të negociuar mospërputhjen e pikëpamjeve, nëse këto shfaqen. Sipas Këshillit, bazuar edhe në përgjigjet e dhëna gjatë intervistës, kandidati {...} demonstroi një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësi për të qenë pjesë e një komuniteti pune, pra aftësinë për të punuar në ekipe me kolegët dhe anëtarët e stafit.

49.3 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore”, duke vlerësuar eksperiencën e kandidatit gjatë karrierës, në punën në ekip dhe në ambiente multidisiplinore, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 2 pikë.

50. Sa më lart, në përfundim të arsyetimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për secilën kategori, kriter, nënkriter dhe tregues, Këshilli i Lartë Gjyqësor e vlerësoi kandidatin {...} në total me 87 (tetëdhjetë e shtatë) pikë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikat 1-6, Seksioni D, Kreu VI, të Vendimit të tij nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, si dhe në Vendimin e tij nr.209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit z. {...}, si më poshtë:

A. Kategoria “Meritat profesionale”:

1. Kriteri “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”:

- a) Nënkriteri “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi” - 2 pikë;
- b) Nënkriteri “Rezultatet e programeve të formimit fillestar” - 0 pikë;

- c) Nënkriteri “Rezultatet e përvojës në profesion” - 4 pikë;
 - ç) Nënkriteri “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”:
 - I) Treguesi “Rezultatet e trajnimeve të tjera” - 0 pikë;
 - II) Treguesi “Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare” - 2 pikë;
 - III) Treguesi “Rezultatet e gradave/titujve shkencorë” - 4 pikë;
 - d) Nënkriteri “Aftësitë gjuhësore” - 1 pikë;
2. Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”:
- a) Indikatori “Origjinaliteti dhe/ose impakti” - 5 pikë;
 - b) Indikatori “Aftësitë analitike dhe hulumtuese” - 5 pikë;
 - c) Indikatori “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja” - 5 pikë;
 - ç) Indikatori “Interpretimi i harmonizuar” - 5 pikë;
 - d) Indikatori “Referencat e praktikës gjyqësore” - 5 pikë;
3. Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional”:
- a) Nënkriteri “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike” - 6 pikë;
 - b) Nënkriteri “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike” - 6 pikë;
 - c) Nënkriteri “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit” - 4 pikë;
 - ç) Nënkriteri “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”:
 - I) Treguesi “Pjesëmarrja në konferenca shkencore” - 4 pikë;
 - II) Treguesi “Mësimdhënie” - 4 pikë;
 - III) Treguesi “Çmime dhe tituj” - 0 pikë;
- B. Kategoria “Meritat morale dhe etike”:
- 1. Kriteri “Shmangia e shfaqjes së pahijshme” - 5 pikë;
 - 2. Kriteri “Nderi dhe dinjiteti” - 5 pikë;
 - 3. Kriteri “Reputacioni” - 5 pikë;
- C. Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale”:
- 1. Kriteri “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur” - 2 pikë;

2. Kriteri “Aftësitë vendimmarrëse” - 4 pikë;
3. Kriteri “Aftësitë e komunikimit” - 2 pikë;
4. Kriteri “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore” - 2 pikë;

Totali - 87 pikë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR